

VENDIM
Nr. 816, datë 31.12.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 82, DATË 14.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NGARKIMIN E AGJENCISË SË BLERJEVE TË PËRQENDRUARA PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 2, të tekstit “Rregullat e prokurimit publik”, bashkëlidhur vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 82, datë 14.2.2018, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Nënndarja 1.25, “Shërbim mirëmbajtjeje rutinë dhe dimërore të rrugëve”, në pikën 1, shfuqizohet.
2. Pikat 4 dhe 5 ndryshohen si më poshtë vijon:

“4. Lidhur me objektet e përmendura në pikat 1.6, 1.7, 1.11, 1.12, 1.13, 1.17, 1.18, 1.19, 1.20 dhe 1.24, të pikës 1, të këtij vendimi, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara të qendërzojë/të fillojë kryerjen e procedurave të prokurimit me paraqitjen e çdo kërkesë nga autoritetet kontraktore.

5. Autoritetet kontraktore, institucionet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, të dërgojnë pranë saj të dhënat teknike e sasiore dhe fondin përkatës për mallrat e shërbimet përkatëse.

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara duhet të informojë Agjencinë e Prokurimit Publik në çdo rast kur konstaton mosrespektimin e afatit kohor të përcaktuar në këtë pikë.”.

3. Në pikën 6, fjala “... udhëzim ...” zëvendësohet me “... urdhër ...”.

4. Në pikën 7 bëhen këto ndryshime:

a) Në fjalinë e parë fjalët “... dhe të unifikuara ...” zëvendësohen me “... dhe/ose të unifikuara ...”.

b) Fjalja e dytë, e shkronjë “b”, me përmbajtje: “Në rastin kur si kriter vlerësimi i ofertës/ofertave fituese është çmimi për njësi, fondi limit do të jetë çmimi i përlogaritur për çdo artikull apo shërbim.”, hiqet.

5. Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“13. Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, gjatë vitit 2019, merr masa për planifikimin dhe kryerjen e procedurave të prokurimit, për mallrat dhe shërbimet e mëposhtme, me qëllim të plotësimit të nevojave të autoriteteve kontraktore nga 1 janari 2020:

- a) Riparim, mirëmbajtje e sistemit ngrohje-ftohje;
- b) Riparim dhe mirëmbajtje automjete;
- c) Mirëmbajtje impiantesh elektrike;
- ç) Shërbim i ruajtjes dhe i sigurisë fizike;
- d) Blerje artikujsh ushqimorë;
- dh) Blerje pajisjesh kondicionimi;
- e) Shërbim gjelbërimi.”.

6. Pas pikës 13 shtohet pika 13/1, me këtë përmbajtje:

“13/1. Përrjashtimisht për vitin 2019, procedurat e prokurimit për blerje karburanti për nevojat e drejtorive të ujitjes dhe kullimit, kryhen nga vetë drejtoritë.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama